



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimarrjes

Gjatë vitit 2025 Këshilli Bashkiak Elbasan ka ushtruar funksionet e tij ligjore dhe administrative në mbështetje të Këshillit Bashkiak, në përputhje me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktet nënligjore, rregulloren e brendshme të Këshillit dhe kërkesat institucionale që burojnë nga organet qendrore.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe forcimit të pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimarrjes, Këshilli Bashkiak ka hartuar dhe publikuar raportin vjetor mbi konsultimin publik. Ky raport synon të paraqesë në mënyrë të qartë dhe të strukturuar aktivitetin e zhvilluar gjatë vitit, duke reflektuar nivelin e përfshirjes së qytetarëve dhe palëve të interesuara në proceset vendimarrëse. Përmes këtij raporti evidentohen aktet e miratuara që kanë kaluar në konsultim publik, si dhe kontributi i dhënë nga publiku nëpërmjet komenteve dhe rekomandimeve, duke garantuar kështu një proces sa më gjithëpërfshirës dhe transparent.

Gjatë viti 2025 janë miratuar gjithsej 161 akte, nga të cilat një pjesë e tyre lidhur project-buxhetin e vitit 2026, me tjetërsimin e pronave të të tretëve, vendosja dhe ndryshimi i taksave dhe tarifave vendore, hartimi i planeve vendore si dhe draft-rregullore për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve publike, kanë kërkuar këshillim me bashkësinë sipas nenit 18 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”.

Nga këto akte, 13 prej tyre janë konsultuar me publikun përpara miratimit nga Këshilli Bashkiak, ku janë zhvilluar gjithsej 37 mbledhje konsultime me publikun gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025.

Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të proceseve të konsultimit publik të zhvilluara nga Këshilli Bashkiak, nuk janë paraqitur komente apo rekomandime me shkrim nga palët e interesuara. Rekomandime të evidentuara janë ato të dhëna gjatë takimeve publike, të cilat janë pasqyruar dhe dokumentuar në procesverbalet përkatëse të mbajtura në këto takime. Këto rekomandime kanë qënë kryesisht gjatë takimeve lidhur me buxhetimin me pjesëmarrje për hartimin e buxhetit të vitit 2026, disa prej të cilave të cilësuar si më të kërkuarat dhe më të votuarat janë pasqyruar në buxhet.